

UDHËZIM
Nr.11, datë 14.6.2011

PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT DHE TË NDRYSHIMIT TË ZËRAVE
KADASTRALË TË TOKËS BUJQËSORE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të kreut VI, pika 3 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.121, datë 17.2.2011 “Për mënyrat e ushtrimit të funksioneve nga drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe zyrat e menaxhimit dhe mbrojtjes së tokës në komuna dhe/ose bashki”,

UDHËZOJ:

1. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Ndryshimi i zërave kadastralë të tokës bujqësore” është kalimi i sipërfaqes së tokës bujqësore të zërit kadastral “arë”, që si e tillë figuron në dokumentacionin kadastral, në zërin kadastral “pemëtores”, “vreshtë” apo “ullishte”, si rezultat i zënies së kësaj sipërfaqeje me kultura drufrutore ose kalimi i zërave kadastralë “pemëtores”, “vreshtë” apo “ullishte”, në zërin kadastral “arë”, si rezultat i pakësimit të këtyre sipërfaqeve me bimë (kultura) drufrutore.

b) “Zënie e tokës bujqësore me pemëtores, vreshta dhe ullishte” është gjendja e sipërfaqes së tokës bujqësore, objekt verifikimi, e mbjellë me drufrutore, në të cilën ekziston më shumë se 50% e numrit mesatar të bimëve për njësi të sipërfaqes (ha).

c) “Numri mesatar i bimëve për njësi të sipërfaqes (ha)” përcaktohet sipas lidhjes nr.1 të këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

ç) “Pakësimi i tokës bujqësore të zërave kadastralë pemëtores, vreshtë e ullishte” është gjendja e tokës bujqësore në momentin e verifikimit, ku në sipërfaqet e mbjella me kultura drufrutore numri i bimëve për njësi të sipërfaqes (ha), për shkaqe të ndryshme, është dëmtuar apo pakësuar në masën mbi 50% të numrit mesatar të tyre, dhe që nuk ka leverdi ekonomike mbajtja e kësaj toke për kultivim të drufrutorëve.

2. Ndryshimi i sipërfaqeve të tokës bujqësore nga zëri kadastral tokë “arë” në zërat kadastralë “pemëtores”, “vreshtë” dhe “ullishte” ose anasjellas, bëhet vetëm me kërkesë të personave fizikë apo juridikë, të cilët e kanë në pronësi private tokën bujqësore dhe të organeve të qeverisjes vendore apo institucioneve të tjera shtetërore që, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore, kanë në administrim/përdorim tokën bujqësore.

Kërkesa bëhet me shkrim dhe përmban identitetin e kërkuarit, si dhe arsyen përse kërkohet ndryshimi i zërit kadastral.

Kërkesa shoqërohet me:

a) fotokopjen e noterizuar të dokumentit të pronësisë, administrimit/përdorimit mbi tokën;

b) planimetrinë e sipërfaqes për të cilën kërkohet ndryshimi i zërit kadastral, me kufijtë e saj qartësisht të dallueshëm në shkallën 1:2500 ose 1 :5000;

c) vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (DAMT) e qarkut mbi emërtimin e zërit kadastral me të cilën figuron e cilësuar sipërfaqja objekt kërkesë në dokumentacionin kadastral.

3. Subjektet e përcaktuara në pikën 2 të këtij udhëzimi, kërkesat për ndryshim të zërit kadastral të tokës bujqësore i paraqesin pranë DAMT-së së qarkut.

DAMT-ja e qarkut shqyrton kërkesën e paraqitur dhe kur këtë e gjen në përshtatje me përcaktimet e pikës 2 të këtij udhëzimi, i drejtohet me kërkesë për verifikim drejtorisë rajonale të bujqësisë (DRB), brenda një muaji nga data e regjistrimit të saj.

Në rastin kur kërkesa nuk është paraqitur sipas përcaktimit në pikën 2 të këtij udhëzimi, DAMT-ja ia kthen subjektit kërkuar.

4. Mbi bazën e kërkesës së DAMT-së qarkut, drejtori i DRB-së, brenda 15 ditëve nga marrja e kërkesës për verifikim të zënies apo pakësimit të sipërfaqes së tokës bujqësore me pemëtore, vreshta dhe ullishte, krijon grupin e ekspertëve të verifikimit.

Grupi i ekspertëve përbëhet nga dy specialistë agronomë të DRB-së.

Në përbërje të DRB-së merr pjesë edhe përgjegjësi i zyrës së menaxhimit të mbrojtjes së tokës (ZMMT) të komunës dhe/ose baskisë, në juridiksion të së cilës kryhet verifikimi.

5. Grupi i ekspertëve, të cilit i vihet në dispozicion i gjithë dokumentacioni i caktuar në pikën 2 të këtij udhëzimi, bën verifikimin në vend të sipërfaqes, objekt i kërkesës për ndryshim të zërit kadastral të tokës bujqësore.

Në përfundim të verifikimit, ky grup përgatit “aktin e verifikimit”, përmbajtja e të cilit pasqyrohet në lidhjen nr.2 të këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Akti i verifikimit mbahet në tri kopje, nga të cilat njëra ruhet në arkivin e DRB-së, kopja e dytë i dërgohet DAMT-së dhe kopja e tretë dërgohet për informim në MBUMK.

6. DAMT-ja e qarkut, pasi ka marrë “akt verifikimin” nga DRB-ja, mbi bazën e tij kryen veprimet e ndryshimit në dokumentacionin kadastral ekzistues dhe i lëshon me shkrim “vërtetimin” e këtij ndryshimi, ushtruesit të kërkesës për ndryshim të zërit kadastral, brenda 15 ditëve nga koha e marrjes së “aktit të verifikimit”.

Përmbajtja e vërtetimit pasqyrohet në lidhjen nr.3 të këtij udhëzimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë e administrimit dhe mbrojtjes së tokës në qarqe dhe drejtoritë rajonale të bujqësisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË, USHQIMIT
DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
Genc Ruli